

20110360871

## L I G J

### **PËR NGARKIM TË REPUBLIKES SË MAQEDONISE ME HUA TE BANKA EVROPIANE PËR RINDERTIM DHE ZHVILLIM SIPAS MARREVESHJES PËR HUA PËR PROJEKTIN PËR NDERTIMIN E AUTOSTRADES SË KORRIDORIT X, NË AKSIN RRUGOR DEMIR KAPI - SMOKVICE**

#### Neni 1

Republika e Maqedonise ngarkohet në Banken Evropiane për Rindertim dhe Zhvillim me hua në vlerë prej 107 000 000 eurosh, si bashkefinancim nacional i dedikuar për realizimin e Projektit për ndertimin e autostrades së Korridorit X, në aksin rrugor Demir Kapi-Smokvice, që pjesërisht do të financohet nepermjet Instrumentit për ndihme paraaderuese - IPA të Bashkimit Evropian.

#### Neni 2

Kushtet dhe menyra e shfrytezimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marreveshje për hua për Projektin për ndertimin e autostrades së Korridorit X, në aksin rrugor Demir Kapi-Smokvice, që do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonise dhe Bankes Evropiane për Rindertim dhe Zhvillim.

Në emer të Republikës së Maqedonise Marreveshjen për hua nga paragrafi 1 i këtij neni do ta nënshkruaje ministri i Financave ose person i autorizuar prej tij.

#### Neni 3

Afati i pageses së huas nga neni 1 i këtij ligji është 15 vite, me grejs periudhe të përfshirë prej tre vitesh. Paga do të bëhet në 25 keste gjysmëvjetore që arrijnë për pagese më 20 prill dhe 20 tetor çdo vit, duke filluar nga 20 prilli 2014, e duke mbaruar më 20 prill 2026.

Shkalla vjetore e kamates është shkallë e ndryshueshme e kamates gjashtëmujore EUROBOR e rritur për 1 % në nivel vjetor.

Republika e Maqedonise do t'i paguaje Bankes Evropiane për Rindertim dhe Zhvillim provizion të njëhershëm në vlerë prej 1 % nga shuma e huas.

Për shumën e mjeteve të paterhequra të huas, Bankes Evropiane për Rindertim dhe Zhvillim do t'i paguhet provizion në lartësi prej 0,5% të shumës së mjeteve të paterhequra të huas në nivel vjetor.

#### Neni 4

Projekti do të realizohet në dy komponente, si vijojnë:

- ndertimi i autostrades së Korridorit X nga Demir Kapi deri në Smokvice dhe
- ndertimi dhe instalimi i sistemit elektronik për arketim të taksave rrugore.

Komponentin e parë të projektit do ta implementojë Struktura operative e përbërë nga Ministria e Financave - Sektori për financim qendror dhe lidhjen e marreveshjeve, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve dhe Agjencia për Rruge Shtetërore.

Komponentin e dytë të projektit do ta implementojë Agjencia për Rruge Shtetërore.

#### Neni 5

Republika e Maqedonise huan nga neni 1 i këtij ligji, do ta paguaje nga Buxheti i Republikës së Maqedonise.

#### Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonise".